

Mars 2026

Të nderuar nxënës, familje, arsimtarë, drejtues dhe anëtarë të komunitetit,

Si Kancelar i Shkollave Publike të Qytetit të Nju Jorkut (NYCPS), si arsimtar me më shumë se dy dekada përvojë dhe si prind i një nxënësi në NYCPS, besoj se nxënësit tanë meritojnë shkolla që janë të sigurta dhe me nivel të lartë akademik. Sot, kjo do të thotë edhe të mësojnë si ta përdorin inteligjencën artificiale (AI) me përgjegjësi.

Për nxënësit e shkollave të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, kjo nënkupton zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe të shkrim-këndimit digjital. Për nxënësit e shkollës së mesme, kjo do të thotë përgatitje për një botë ku AI tashmë po modelon karrierat dhe industri të tëra. Në të gjitha moshat, kjo do të thotë të bashkëpunojmë me nxënësit, arsimtarët, drejtuesit dhe familjet për të siguruar që AI të përdoret në mënyrë të sigurt, të përmirësojë të të mësuarit e nxënësve dhe të shërbejë si mbështetje, jo si zëvendësim, për arsimtarët. AI është e pranishme dhe përgjegjësia jonë është të vendosim masa të forta mbrojtëse në të gjithë sistemin, ta përdorim atë në mënyrë transparente dhe me përgjegjësi, dhe në mënyrë të përshtatshme për moshën.

Për ta çuar këtë punë përpara, kemi publikuar udhëzime paraprake për mënyrën se si AI mund të përdoret në shkollat tona. Këto udhëzime synojnë të përcaktojnë pritshmëri të qarta për të mbrojtur nxënësit tanë, për të mbështetur arsimtarët dhe për t'i mbajtur familjet të informuara.

Mendimi juaj ka rëndësi; ju lutemi shpreheni atë ndërsa vazhdojmë këtë punë. Këtë pranverë, ne do t'i zgjerojmë këto udhëzime me një Udhëzues më të plotë për AI, të formësuar nga zërat e komunitetit si zëri juaj.

Ju lutemi vizitoni schools.nyc.gov/AI për të shqyrtuar udhëzimet paraprake dhe për të plotësuar një anketë të shkurtër për sugjerime. Anketa do të jetë e hapur për 45 ditë rresht deri më 8 maj 2026.

E di që AI ngre pyetje të reja për të gjithë ne. Ndërsa ecim përpara, do të vazhdojmë të dëgjojmë, të reflektojmë dhe të bëjmë përshtatje të kujdesshme, duke e pasur gjithmonë në qendër sigurinë dhe të të mësuarit e nxënësve.

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me qasjen në anketën e sugjerimeve, ju lutemi shqyrtoni informacionin e disponueshëm në schools.nyc.gov/AI. Faleminderit që bashkëpunoni me ne për t'i ndihmuar nxënësit tanë të jenë të sigurt, të mësojnë dhe të zhvillohen.

Në bashkëpunim,



Kamar H. Samuels
Kancelar